



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**

**MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY**

**MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU**

Kabineti i Ministrit

Office of Minister

Kancelarija Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zbatimi i planit dhe programit për klasën e trembëdhjetë të lëndëve të përgjithshme për shkollat profesionale

NUMËR: MASHT [I] 37/2006

DATË: 31 07.2006

Në bazë të nenit 1.3 paragrafi (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 6 të Ligjit mbi Arsimin dhe Aftesimit Profesional si dhe nenit 6.1 paragrafi (d) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është zbatimi i planit dhe programit mësimor për klasën e trembëdhjetë të lëndëve të përgjithshme për shkollat profesionale, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit fillor dhe të mesëm.

Neni 2

Plani dhe programi

Plani dhe programi i ri për klasën e trembëdhjetë të lëndëve të përgjithshme për shkollat profesionale i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3
Zbatimi

1. Ky plan dhe program për klasën e trembëdhjetë të lëndëve të përgjithshme për shkollat profesionale zbatohet nga viti shkollor 2006/2007.
2. Me zbatimin e planit dhe të programit të klasës së trembëdhjetë të lëndëve të përgjithshme për shkollat profesionale shfuqizohen planet dhe programet e deritashme të klasës së katërt të shkollave të mesme profesionale.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi 8 dite pas publikimit të tij ne Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Agim Veliu, Ministër